

PLATFORMA MBI KANDIDIMIN PËR VENDIN VAKANT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

NGA: Ludovik DODAJ, me funksionin e prokurorit, kandidat për vendin vakant në Këshillit e Lartë të Prokurorisë.

OBJEKTI:

- Prezantimi i platformës në lidhje me qëllimin e kandidimit dhe me objektivat që do përmbushen në rast se do të zgjidhem si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

BAZA LIGJORE:

- Ligji nr.115 datë 03.11.2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”

Të nderuar kolege dhe kolegë,

mbështetur në ligjin “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” paraqes platformën e kandidatit për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ku do të parashtroj qëllimet dhe objektivat e kandidimit tim në këtë pozicion për të cilin më duhet edhe mbështetja Juaj.

Jam nxitur të marr pjesë në këtë proces fillimisht nga mundësia që na dhanë ndryshimet ligjore, për të kontribuar në organizimin e sistemit të drejtësisë si dhe për të bërë të zbatueshme idetë dhe konkluzionet që i kemi nxjerrë nga praktika gjatë viteve, e në vijim mendoj se plotësoj kriteret dhe kushtet ligjore për të më mundësuar kontributin tim në institucion.

Më është dashur të angazhohem maksimalisht për këtë paraqitje për t’i dhënë vetes një mundësi më shumë në planin personal për zhvillimin e sistemit të drejtësisë si dhe konkretisht në dëshirën për të realizuar çfarë kam menduar se duhet edhe më shumë institucionin e Prokurorisë.

- Eksperienca ime e gjatë, më jep mundësinë që të kem një analizë të qartë për institucionin e prokurorisë dhe në pjesëmarrjen time do të përfaqësoj denjësisht funksionin dhe vlerat e prokurorit, si anëtar i këshillit do të mundem të jem i qartë në propozimet e mia në këtë funksion të këshillit, si dhe do mundem të gjykoj drejtë në vendimarrjet për kolegët e mi.
- Një element me rëndësi në figurën time është zhvillimi i karrierës time edhe si drejtues i Prokurorisë së Rrethit po ashtu dhe asaj të Apelit, ku kam njohur nga afër problematikat që lindin në organizimin e punës në Prokurori, shpërndarjen e çështjeve, menaxhimin e ngarkesës, përfaqësimi i denjë i akuzës në gjyq, ndjekjen me përpikmëri deri në fazën e ekzekutimit të një vendimi, për të cilat në Këshill do t’i kem në konsideratë për orientimin e politikave dhe strategjive të prokurorisë si dhe për të përcaktuar prioritetet e këtij institucioni.
- Në karrierën time kam ditur të ndërtoj marrëdhëniet ndërinstitucionale, duke mbrojtur figurën dhe integritetin e prokurorit në raport me ndërhyrjet e padrejta, për të rritur gjithmonë e më shumë besimin dhe vlerat e këtij institucioni tek publiku.

- Gjatë punës time si prokuror, në hetime dhe në përfaqësimin e akuzës kam ndërmarrë vetëm hapa në përputhje me parimin e ligjshmërisë, kam qënë transparent në zbatimin e ligjit dhe diskret në kryerjen e funksionit tim. Për realizimin e këtij funksioni jam prirur gjithnjë nga e drejta, ligji dhe etika.
- Në karrierën timë më është dashur të bashkëpunoj me autoritet analoge të shteteve të tjera, si Britania e Madhe, Belgjikë, Itali ku kemi shkëmbyer praktika dhe zgjidhje ligjore, nga të cilat kam përfituar një këndvështrim tjetër të zbatimit të ligjit dhe të funksionit të prokurorit në respektim të të drejtës së individit në bazë të përcaktimeve të Konventës Europiane.
- Unë si prokuror jam përballur ashtu si dhe ju, me situata të rënda të kriminalitetit, që në periudha të caktuara kanë arritur deri në atë pikë që kanë ulur edhe veprimtarinë e funksionit të institucioneve të vendit dhe përpjekjet e mia kanë qënë për të rivendosur rolin e figurës së prokurorit dhe për të rritur besimin ndaj qytetarëve për funksionimin e shtetit ligjor.
- Sic e dimë organi i Prokurorisë ka pësuar ndër vite ndryshime thelbësore të shoqërua me ndryshime të gjëra të legjisllacionit si të sistemit në tërësi të drejtësisë ashtu edhe të funksionit të prokurorit për të cilët na është dashur të përshtatemi dhe të qëndrojmë në informacion të vazhdueshëm.
- Në formimin tim profesional nuk jam mjaftuar vetëm me punën e shtuar personale mbi kuptimin, interpretimin dhe zbatimin e normës por jam angazhuar edhe në trajnimet vazhduese që shkolla e Magjistraturës ka zhvilluar në vijimësi. Kam qënë aktiv në këto pjesëmarrje dhe gjithmonë kam zgjedhur cfarë kam menduar se duhet përforcuar në profilin tim si prokuror.
- Kam njohur dhe zbatuar me përpikmëri etikën profesionale e cila më ka shoqëruar që nga dita e parë e punës e në vijim, jo vetëm në institucion por kudo kam patur në konsideratë qënie time si prokuror, për të rritur gjithmonë e më shumë besimin e qytetarëve tek drejtësia.

Në vijim të kësaj platforme dua të ndalem edhe në paraqitjen e disa nga objektivat që do kem në vëmendjen time gjatë funksionit të anëtarit të Këshillit.

- Fillimisht mendoj se fryma e zbatimit të ligjit do të vijojë të më shoqërojë edhe në kryerjen e funksionit tim si anëtar i Këshillit, në lidhje me përcaktimin e prioriteteve të institucionit të prokurorisë si dhe të mbështetjes së kolegëve të mi.
- Konkretisht plotësimi i vendeve vakante me prokurorë të Prokurorisë pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe atyre pranë Gjykatave të Apelit, është një çështje imediate që kërkon vullnet, përkushtim dhe angazhim të institucioneve të drejtësisë. Të gjithë ne prokurorët jemi përballur me një volum pune mbi normalen e çështjeve për një prokuror, duke mos qënë komod hera herës në realizimin e detyrave, prandaj e ndjej si detyrë që të ngre këtë problematikë të parën për të mundësuar të paktën shpërndarjen proporcionale sipas nevojave të prokurorisë si dhe sipas ngarkesës që ka cdo prokuror. Do të ishte me vënd të nxisim normimin e volumit të punës në aspektin e ngarkesës, sic përcaktohet edhe në rezolutën e Kuvendit të Republikës Shqipërisë.
- Gjithashtu nisur nga fakti se gjatë funksionit do të më duhet të ndalem në vlerësimin e kolegëve të mi, do të angazhohem të bëj vlerësim të përgjithshëm të figurës të secilit dhe jo të ndalem vetëm në gjykimin e ngushtë të rastit konkret, për të mos i

mohuar kështu vlerat në tërësi që përfaqëson prokurori i secilit rast që do të jetë në diskutim. Do të mundohem të jap kontributin tim maksimal për të identifikuar prokurorët që kanë punuar në zbatim të normës ligjore dhe janë angazhuar me përkushtim maksimal në ushtrimin e funksionit të tyre. Në këtë rast do të sjellim jo vetëm nxitjen për të arritur figura të tilla por edhe do të motivojmë prokurorin e përkushtuar, nisur nga parimi i ligjshmërisë dhe meritokracisë.

- Në përzgjedhjen e prokurorëve do të nagazhohem edhe më shumë për të të qënë i paanshëm, i drejtëpërdrejtë dhe i ligjshëm pasi vlerësimi i secilit prokuror duhet të përballet vetëm me kriteret ligjore.
- Do të kem në objektivin tim marrëdhënie të drejta dhe profesionale me shkollën e Magjistraturës për të ngritur nivelin e kualifikimit të prokurorëve, në fushat e nevojshme sic janë ndryshimet e fundit të legjislacionit, kështu duke i krijuar mundësinë secilit prokuror për trajnimet vazhduese.
- Këshilli I Lartë I Prokurorisë duhet të raportojë në Kuvend një herë në vit të paktën, për punën e Këshillit si dhe në lidhje me përmirësimet e nevojshme, të cilat do të përmbliidhen në një raport vjetor. Në këtë rast do të angazhohem për të patur një bashkupunim të shëndetshëm në mënyrë që të cojmë në Kuvend cfarë është me rëndësi për ta, po ashtu rezultative dhe për Këshillin për të evidentuar edhe problematikat e institucionit të Prokurorisë.
- Në vëmendjen time do të jenë edhe krijimi i kushteve të duhura për realizimin e funksionit kushtetues që t'ju mundësohet logjistika e duhur në shërbim të realizimit të objektivave të organit të prokurorisë.
- Gjatë funksionit tim si prokuror në zbatimin e normalve ligjore kam patur herë pas here idetë përkatëse se si norma mund të jetë më e mundshme për t'u zbatuar, si duhet të jetë ligji procedural dhe ai material, si mund të funksionojë më mirë institucioni i Prokurorisë dhe sistemi i drejtësisë në tërësi, prandaj mendoj se në kryerjen e detyrës së anëtarit të këshillit në funksionin e dhënies së opinioneve ligjore do të jem konkret në propozimet e mia.

Ashtu sic kam vepruar gjatë gjithë detyrës time si prokuror do të vijoj me korrektësi, seriozitet dhe transparencë të përfaqësoj prokurorin në Këshill, që nëse më besohet, do të kryej në zbatim të ligjit dhe në përputhje të plotë me etikën, duke bërë të mundur një prokuror për Ju në Këshill dhe një anëtar i Këshillit nga Prokurorët.

Ju faleminderit
Ludovik DODAJ
Prokuror

